VENDIM
Nr. 175, datë 19.3.2014

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 358, DATË 1.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SIGURINË NË DET, PLAZHE DHE NË UJËRAT E BRENDSHME NË THELLËSI TË TERRITORIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9861, datë 24.1.2008 "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror" të ndryshuar, të ligjit nr. 8663, datë 18.9.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor me tonazh nën 20 NT", të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9734, datë 14.5.2007 "Për turizmin" të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 358, datë 1.6.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 3 të kreut I, "Dispozita të Përgjithshme", shtohet përkufizimi, me këtë përmbajtje:

""Stacione plazhi" është veprimtaria turistike e ushtruar nga personat fizikë ose juridikë në strukturat e pozicionuara në breg të detit, të liqeneve ose lumenjve, të pajisura për plazh me kabina, dhoma zhveshjeje, shërbime higjienike dhe dushe. Strukturat mund të jenë të pajisura me impiante të tjera dhe pajisje për përgatitjen e pijeve dhe ushqimeve dhe për ushtrimin e aktiviteteve të tjera të lidhura me plazhin, si: banja dielli, kurat termale, aktivitete sportive dhe argëtuese.".

2. Në shtojcën "B", të përmendur në pikën 13 të kreut III "Shtojcat e vendimit", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Titulli i shtojcës "B" ndryshohet dhe zëvendësohet me "Kërkesat për sigurinë në plazhet publike";

b) Pikat 5 dhe 6 shfuqizohen;

c) Pas shtojcës "B-2" shtohet shtojca "B-3" me këtë përmbajtje:

"Shtojca B-3

Kriteret që duhet të përmbushen për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit

a) Të ketë hapësira të gjelbra ose zona të përbashkëta, të cilat të jenë të paktën 1% deri në 5% e sipërfaqes së përgjithshme të stacionit të plazhit.

b) Çadrat dhe ndenjëset e pushuesve të vendosen jo më afër se 7.5 m nga bregu.

c) Hapësira prej 2.5 m përpara brezit të parë të çadrave të jetë e lirë për t'u përdorur nga publiku me pajisjet e veta.

ç) Hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) në stacionet e pozicionuara në zonat ranore duhet të jetë më e madhe se 2,5 m.

d) Hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) në stacionet në zona shkëmbore duhet të jetë më e madhe se 2 m.

dh) Të ketë 1 dush me ujë të ëmbël për çdo 50 çadra.

e) Të jetë e pajisur me shërbime higjienike, të paktën 2 për 50 çadra, nga të cilat 1 për burra, 1 për gra.

ë) Të ketë kabina zhveshjeje të paktën 2 për 50 çadra.

f) Të jetë i pajisur me zonën e ndihmës së shpejtë në shërbim të pushuesve.

g) Të jetë i pajisur me telefon publik.

gj) Të jetë i pajisur me kontejnerë dhe kosha me kapak për hedhjen e mbeturinave.

h) Çdo çadër duhet të jetë e pajisur me krevat plazhi.

i) Të reklamojë identitetin e subjektit dhe çmimet për shërbimin e ofruar.

j) Stafi që shërben pranë stacioneve të plazhit të ketë uniformë dalluese.

k) Të zbatojë kodin e etikës globale në fushën e turizmit.

l) Shërbimi për pastrimin dhe mirëmbajtjen e stacionit të plazhit të jetë ditor, në mëngjes dhe në mbrëmje pas mbylljes së plazhit.

ll) Në të gjithë territorin e plazhit ndalohet vendosja e elementeve ndarëse, gardhe apo të tjera të ngjashme me to.".

3. Çdo njësi e qeverisjes vendore, që ka në përgjegjësi administrimi dhe që është subjekt autorizimi për përdorim, të lërë në dispozicion për "Plazh publik" 20% të territorit të përgjithshëm të plazhit. Plazhi publik të

menaxhohet dhe të jetë në administrim të njësive të qeverisjes vendore. Shpërndarja për stacionet e plazhit publik dhe privat të bëhet në mënyrë proporcionale.

4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe njësitë e qeverisjes vendore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama